



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 11.6. 2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Liburn Aliu, Salih Zyba dhe Danush Ademi.

Munguan: Etem Arifi dhe Sergjan Mitroviç.

Të ftuar: Xhelal Selmani, Zëvendësdyrëtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU); Zogë Spahiu, Udhëheqëse e Njesisë së Inspektimit; Qamil Musa, dyrëtor i Departamentit të performancës dhe Refik Ramaj, dyrëtor i Departamentit të tarifave.

Milazim Berisha, kryetar i Shoqatës së prodhuesve të qumështit; Idriz Mulaj, Produkte natyrale SH.P.K. dhe Naim Berisha, Agribao.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.5.2019,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2018;
4. Votimi për Rekomandimin e auditimit të performancës, procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë.
5. Takimi me tre përfaqësues të Shoqatave aksionare për farëra të kungujve, laktofriza dhe të qumështit.
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Salih Salihu, propozoi që të shtohet si pikë rendit të ditës shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-130 për produktet biocide. Ndërsa **Salih Zyba**, propozoi që të ndryshohet renditja e pikave për shkak të mysafirëve të ftuar.

Kryetari konstatoi se komisioni, miratoi rendin e ditës me ndryshimin e propozuar nga deputeti Salih Salihu.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 27.5.2019

Kryetari konstatoi se komisioni, me 8 vota për dhe një abstenim, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.5.2019.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2018

Kryetari Nitaj, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe tha se Raporti i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2018 është obligim nga Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Autoriteti paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ai i shprehu mirëseardhjen zëvendës drejtorit z. Xhelal Selmani dhe përfaqësuesve të tjerë të ARRU-së dhe i ftoi që ta paraqes raportin.

Xhelal Selmani, zëvendës drejtor i ARRU-së, fillimisht tha se Raporti paraqet aktivitetet dhe arritjet në përmbushjen e Planit Strategjik dhe Planit të Punës, gjithashtu edhe arritjet dhe ngecjet e ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë. Duke pasur parasysh bazën kryesore të themelimit dhe veprimtarinë e ARRU-së: sigurimin e shërbimeve të ujit sipas standardeve të përcaktuara, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, sigurimi që ofruesit e shërbimeve veprojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe njëkohësisht të jenë financiarisht të qëndrueshëm, konsideroj se ARRU i ka përmbushur objektivat e planifikuara për vitin 2018.

Ai në vazhdim paraqiti në pika të shkurta, aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2018:

Përtëritja e licencave për të gjithë ofruesit e shërbimeve, për periudhë 8 vjeçare, pasi të njëjtave u ka përfunduar vlefshmëria në vitin 2018. Aktualisht shtatë KRU-të dhe N.H. “Ibër Lepenci” janë të licencuar.

Rishqyrtimi i Tarifave, janë aprovuar tarifat për vitin 2018 me ç’rast tarifat fikse për shërbimet publike të ujit për konsumatorët jo-shtëpiak (komerciale dhe atyre institucionale) duke filluar nga viti 2018 është zvogëluar nga 3.00 €/muaj (sa kanë paguar deri më 2017) në 2.00 €/muaj. Gjatë shqyrtimit të tarifave për vitin 2019 (aktivitet që i përket vitit 2018), tarifat vëllimore të shërbimeve të furnizimit me ujë të vitit 2019, për konsumatorët shtëpiak në nivel të sektorit nuk kanë ndryshuar në krahasim me tarifat e vitit 2018, kurse tek konsumatorët jo-shtëpiak është bërë ulje e tarifave vëllimore si rezultat i uljes të shkallës së ndër- subvencionimit sektorial.

Monitorimi i Performancës së Ofruesve të Shërbimeve, ofrohet një pasqyrë e zhvillimeve të sektorit dhe paraqiten zhvillimet dhe ngecjet në të gjitha fushat. Është ky një aktivitet i cili duhet të na shërbejë të gjithëve që të fokusohemi dhe kontribuojmë brenda kompetencave tona për përmirësimin e fushave në të cilat paraqiten ngecjet.

Si rezultat i **inspektimeve** dhe masave të ndërmarra, gjatë vitit 2018 janë kompensuar 290 konsumatorë të dëmtuar të identifikuar gjatë inspektimeve (edhe pse të njëjtët nuk kanë parashtruar asnjë lloj ankese). Nga të gjeturat gjatë inspektimit, për moszbatimin mënyrës së përcaktuar të faturimit në rregulloren e ARRU të konsumatorëve në rastet me ujëmatës të përbashkët (ndërtesat e banimit kolektiv), është gjobitur njëri prej ofruesve të shërbimit. Pas gjobitjes ne kemi vazhduar të kontrollojmë mënyrën e faturimit të kësaj kategorie dhe e konsiderojmë sukses të masave të ndërmarra nga ARRU përmirësimin e faturimit të kësaj kategorie të konsumatorëve në nivel të sektorit.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të konsumatorëve është bërë plotësim ndryshimi i Rregullores për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në të cilën është ndaluar faturimi i konsumatorëve pa matje. Aktivitet i inspektimit për zbatimin e kësaj rregullore ka filluar në vitin 2018 dhe është në vazhdimësi gjatë vitit 2019.

Mbështetja për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, fakti që gjatë vitit 2018 në Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve janë adresuar dhe shqyrtuar 319 ankese, pajtimi i shumicës së

konsumatorëve me vendimet e marra si dhe vendimet e gjykatës për të lënë në fuqi vendimet e këtyre komisioneve në rastet kur konsumatorët nuk janë pajtuar me vendimet e marra, tregojnë besueshmërinë dhe paanshmërinë e ARRU-së.

Në kuadër të **angazhimeve ndërkombëtare**, ai përmendi: nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me Rregullatorët e shteteve tjera si dhe pjesëmarrjen aktive në Asambleenë e Përgjithshme dhe Grupet Punuese të Shoqatës së Rregullatorëve Evropian të Ujit (WAREG).

Pyetjet e anëtarëve të komisionit:

Besa Gaxherri, për auditimin e pasqyrave financiare për 2017, pyeti a janë sanuar rekomandimet e auditorit? Pastaj, janë 7 kompani rajonale të ujësjellësit ndërsa 11 komuna janë të papërfshira në kuadër të tyre dhe pyeti se cka është bërë në lidhje me këtë? Ndërsa në fund tha se Ligji i ri për Rregullimin e shërbimeve të ujit ka kalu në lexim të dytë dhe amendamenti i komisionit i përgatitur bashkë me ARRU-në nuk ka kalur, në lidhje me pagesën e institucioneve fetare dhe u sugjeroi atyre se duhet me kërkua nga Qeveria për të marrë subvencione për të gjitha objektet fetare.

Liburn Aliu, për “ndalimin e faturimit pa matje”, pyeti deri në çfarë faze ka mbërri ky proces, konkretisht a vazhdon të bëhet paushall dhe si bëhet? Pastaj si ndahet paushalli sipas familjeve, në rastet e banesave kolektive që kanë vetëm një ujëmatës ose nuk kanë fare? Për tarifën për kyqjet e reja, në Ujësjellësin rajon Prishtina, kam vërejtë se çështja e faturimit të kyqjes nuk figuron në sistemin e brendshëm dhe pyeti si rregullohet kjo çështje?

Lutfi Zharku, në lidhje me tarifën kërkoi shpjegim, pse është bërë rritja e tarifave për konsumatorë shtëpiak (përmendi kompanitë Prishtina, Hidroregjioni etj) kurse zbritje e tarifave për konsumatorë josshtëpiak? Çfarë masa janë duke u ndërmarrë nga kompanitë për zvogëlimin e ujit të pafaturuar, kur dihet se kemi 60% të ujit të pafaturuar? dhe shtoi se këto kompani nëse vazhdojnë kështu ato nuk mundën me u vetëmbajtë.

Andin Hoti, për shtimin e ujit të pafaturuar e cila është në trend rritje prej 2014 -2018, që aktualisht është 87 milion, pyeti pse po ndodhë kjo dhe cila është strategjia që është ndërmarrë për me ndalë këtë? Pastaj për të hyrat e KRU për 2018, të planifikuara janë 391,130 ndërsa të inkasuara 391, 133, pse janë 3 euro më shumë apo është ndonjë gabim teknik? Pse Prizreni e Rahoveci kanë tarifa 50 cent e Prishtina 48 cent, pse është ky dallim në çmim?

Salih Zyba, duke i’u referuar fjalës së zv.drejtorit, “janë aprovu tarifën nga 3 euro në 2 euro” pyeti se cili ka qenë qëllimi për këtë ulje dhe a ka qenë kjo kërkesë e qytetarëve apo ndërmarrjeve? Pastaj për investimet nga donatorët e huaj në këto ndërmarrje regjionale, te përcaktimi i tarifave që është e njëjtë si me qenë investim i ndërmarrjes, Qeverisë por edhe donacion ose participim i vetë qytetarëve, kto tarifa nuk po kihen parasysh për banorët që kanë kontribua në realizim të një projekti, dhe pyeti cili është roli i huaj në mbikqyrjen e këtij dallimi, kur bëhet vetëparticipimi ose investimi qevritar, komunal apo i ndërmarrjes regjionale? Pasi që në pjesën veriore mungon pagesa e ujit, pyeti pse nuk ka asnjë rekomandim nga auditori për këtë?

Salih Salihu, për sasinë e ujit të pafaturuar, pyeti se a është kjo nga ekonomitë familjare apo bizneset që përdorn ujë në sasi më të madhe siq janë industritë, autolarjet, etj.? A keni regjistër të objekteve të kultit sa jë gjithsej në Kosovë pasi që ato marrin pjesë në sasinë e ujit të pafaturuar?

Ganimete Musliu, si pasojë e keqpërdorimit të ujit tha se kemi mungesë të ujit të pijes dhe pyeti se a bëhet ndonjë analizë e pakënaqësisë qytetare, cila është forma që i merrni vërejtjet e tyre, dhe a ju ktheni përgjegjë ndonjëherë konsumatorëve për pakënaqësitë e tyre? Pasi që u potencua mungesë e stafit të mjaftueshëm për inspektion, pyeti a keni bërë kërkesë për shtimin e numrit të inspektorëve. Ndërsa në lidhje me leximin jo të saktë të ujëmatësve, pyeti pse bëhet kjo dhe a është marrë në përgjegjësi dikush për këtë?

Danush Ademi, tha se ka keqpërdorim të madh ujit dhe pyeti çka keni ndërmarrë konkretisht ndaj autolarjeve që i kemi në çdo 100 metra, pasi që ata e shfrytëzojnë ujin e pijshëm e qytetarët kanë mungesë për pije? Ndërsa pati vërejtje edhe rreth vendosjes dhe leximit të ujëmatësve.

Kryetari Nitaj, pyeti: si është faturimi në veri dhe a paguajnë ata si dhe a ka pjesë të tjera përveq veriut të populluara me popullatë serbe që nuk paguajnë? A i keni obligu kompanitë e ujit me i vendosë ujëmatësit në banesat kolektive? dhe vazhdoi se pjesa dërmuese e banesave në Prishtinë në katet e para kanë biznese: dhe si bëhet dallimi i atyre qytetareve nga bizneset, si janë trajtu ata gjatë ndarjes së së tarifave të pagesës. A keni informata të sakta nga kompanitë e ujit, se sa biznese nuk kanë fare ujëmatës dhe e shfrytëzojnë lidhjen në ndërtesat kolektive, duke u faturuar si ekonomi familjare ose nuk faturohen fare?

Ndërsa për barazimin e mundshëm të tarifave të bizneseve me ato të ekonomive familjare tha se nuk është e drejtë pasi që shumë prej shfrytëzuesve ujit e shfrytëzojnë atë si lëndë të parë dhe nuk mund të trajtohen njetë si ekonomitë familjare. Po ashtu dhe burimet natyrore do të duhej ti nënshtrohen faturimit sepse janë pasuri natyrore kombëtare dhe jo pronësi individuale.

Zëvendësudrejtori Selmani dhe përfaqësuesit e ARRU-së iu përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit:

- Sa i përket Auditimit për vitin 2018 dhe nuk kemi asnjë rekomandim, i kemi përmbushë të gjitha dhe auditori i Ministrisë së financave e ka dorezu raportin pa snjë rekomandim.
- Për komunat që janë jashtë integritit: në Komunën e Gjilanit, prej dhjetorit të 2018 komuna e Ranillugut është inkuadru në kuadër të kompaninë rajonale “Hidromorava” dhe ka fillu faturimi, tash ka mbetë edhe disa punë teknike sa i përket komunës së Klllokotit, Parteshit dhe Novoberdës. Është inkuadru edhe Hani i Elezit në kuadër të “Bifurkacionit”, ka kërkesë edhe prej komunës së Shtërpces me u inkuadru në kuadër të Bifurkacionit, edhe këtu kërkohen disa investime dhe besoj se deri në fund të vitit do të kryhet.
- Sa i përket humbjeve të ujit të objekteve të kultit, me aprovimin e Ligjit të ri për rregullimin e shërbimeve të ujit, amendamenti i propozuar nga ARRU dhe Shukos nuk ka kalu që parashihte që objektet e kultit me hy në kategorinë e amvisërisë, dhe në bazë të një analizë që kemi sa i përket objekteve të kultit 17% marim pjesë në faturim në konsumatorët e bizneseve e që paraqesin humbje.
- Për faturimin pa matje, deri në mars të 2018 kemi pasë të aprovuar prej Rregullatorit të kompanisë kemi pasë të aprovuar një lloj faturimi paushall për kategorive të ndryshme të konsumatorëve, mirëpo me hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, është ndalu faturimi pa matje vetëm është aprovu një lloj faturimi deri në vendosjen e ujëmatësve të përbashkët për konsumtarët e banesave kolektive. Në tërë Kosovën janë rreth 13 000 konsumatorë që vazhdojnë me u faturu pa matje.
- Faturimi kolektiv është bërë në bazë të kalkulimit të mostrave të shpenzimeve, mostrat janë marrë prej të gjitha kompanive, konsumatorët që kanë matje në kaudër të banesave kolektive (kemi) është nxjerre një mesatare dhe në bazë të asaj është përcaktu një faturim paushall deri sa 6 muaj kompanive afat me i vendosë ujëmatësat e përbashkët.
- Në ndërtesat e banimit kolektiv të para luftes është e pamundur që të bëhet çkyqje individuale si dhe me i obligu konsumatorët me i vendosë ujëmatësit brenda në banesë, ndërsa vendosja jashtë nuk është e mundur teknikisht.
- Inspektorët para dy vite në Prishtinë pasi që ka më shumë biznese dhe në kontrollimin e bërë, ka vërejtë se një numër i madh i bizneseve kanë ujëmatës individual dhe kur merret leximi i ujëmatës të përbashkët ky leximi i ujëmatës individual zbritet prej kësaj shume, sepse ka edhe nëpër banesa konsumatorë që kanë ujëmatës individual.
- Kemi vërejtë në disa kompani që mosleximi i ujëmatësve është më i madh dhe i kemi ndëshku me gjobë. Njësia e inspektimit është formu që 1vit e gjysmë me një person dhe kemi bërë kërkesë për numër shtesë të stafit.
- Për pyetjet rreth tarifave të kyqja e banesave, ka dy lloje të kyqjes, nëse donatori e bën kyqjen e një fshati ose lagje atëherë konsumatori nuk paguan fare takse të kyqjes, kjo është vendosë prej këtij viti. Ndërsa taksa e kyqjes nëse nuk është donacion, është 10 euro.

- Për rritjen e tarifave ka rregulla strikte janë edhe rregulla ndërkombëtare si dhe kemi një softver që bën kalkulimin. Në disa kompani janë vu në funksion impiantet e trajtimit të ujerave të zeza dhe kto e kanë ngrite koston në përgjithësi.
- Për dallimin e çmimit të ujit, tha se kostoja e prodhimit të ujit dallon nga regjioni në regjion.
- Në veri uji vazhdon të faturohet nga kompania rajonale “Mitrovica”, ai del në pjesën veriore dhe faturohet me 17 cent sepse e marrin nga Ibër Lepenci me shumicë, ata nuk e paguajnë por faturimi është i rregullt, kjo nuk ndikon në tarifën e pjesës jugore. Qeveria çdo vit ndan në emër të subvencioneve nga 900 mijë euro. Ndërsa nuk ka probleme në pjesët e tjera, psh. komuna e Graçanicës është në kuadër të Prishtinës është pagues i rregullt dhe aty shkalla e inkasimit është gati 100%.
- Në ndërtesat e banimit kolektiv, bizneset obligohen të vendosin ujëmatës dhe ata kanë ujëmatës. Ndërsa pas luftës bizneset kanë pagu më shumë se amvisëritë sepse fuqia e pagesës ka qenë më e lehtë, mirëpo në takim edhe me konsulentët tanë na kanë sugjeru që tarifën për biznese duhet me zbritë, sepse nuk ka logjikë kjo. Kemi spitalin e Prizrenit që është çkyqur, pastaj një fabrikë në Prizren që është çkyqur sepse s’ka llogari me pagu, për këtë arsye duhet me i ndihmu edhe bizneseve.

Në fund **Zëvendësrejtori Selmani**, shtoi se humbjet e ujit 57% për vitin 2018, janë të mëdha, mirëpo sektori i ujit në krahasim me rajonin është shumë më i stabilizuar dhe me humbje më të vogla se vendet e rajonit siq janë: Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Bulgaria. Ndërsa problemi më i madh mbetet përpunimi i ujerave të zeza.

Kryetari Nitaj, i falendëroi përfaqësuesit e ARRU-së për raportimin.

Pas diskutimeve, kryetari i ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe pas votimit konstatoi se Komisioni, me 6 vota për dhe 1 kundër, vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

Raport me rekomandime

Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2018.

4. Votimi për Rekomandimin e auditimit të performances, procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë

Kryetari, i njoftoi deputetët se pas mbledhjes së përbashkët me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ku së bashku me MBPZHR dhe ZAP është shqyrtuar Raporti i auditimit të performances, procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë, Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili ka organizuar këtë mbledhje, ka përgatitë dhe votuar raportin me rekomandime për seancë plenare dhe ne nuk kemi nevojë ta votojmë përsëri sepse ajo është kompetencë e këtij komisioni.

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-130 për produktet biocide

Salih Salihu, kryesues i Grupit të punës për Projektligjin Nr. 06/L-130 për produktet biocide, tha se ky gryp i ka mbajtë tri mbledhje së bashku me përfaqësuesit e MMPH-së, sponzorizuese e këtij projektligji dhe janë përgatitë 24 amendamente, shumica e tyre janë ndryshime teknike dhe terminologjike dhe kërkoi nga deputetët të votohen dhe të procedohen për komisionet e përhershme.

Salih Zyba, kërkoi që mos të votohen sot amendamentet, pasi që materialin e kanë marrë në mbledhje.

Kryetari, propozoi që votimi të shtyhet për mbledhjen e radhës, me të cilin u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

6. Takimi me tre përfaqësues të Shoqatave aksionare për farëra të kungujve, laktofriza dhe të qumështit.

Kryetari, së pari i përshëndeti dhe kërkoi nga të ftuarit që të paraqesin shqetësimet dhe kërkesat e tyre.

Idriz Mulaj, nga kompania *Produkte natyrale të Kosovës*, tha se kjo kompani në bashkëpunim me kopmaninë “Estyria” nga Austria bëjnë kultivimin e kungullit (farës së kungullit industrial). Farat për mbjelljen e kungujve vijnë nga Austria, mbjellen dhe pas vjeljes farat kthehen te kompania Estyria në Austri për përpunim. Ai tha se kanë problem me kodin 12079920 ky kod është unik për të gjithë tregun e BE-së . kodin e vendosë dogana dhe duhet me regullu këtë qështje në mes doganës dhe Ministrisë së financave. Kemi kërkua nga departamenti i farërave dhe askush nuk merr përgjegjësinë dhe kërkojmë me u inicu prej komisionit parlamentar si problem. Me pakot fiskale 1 dhe 2 të gjitha produktet e farërave që vijnë për mu mbjellë janë të lirume, mirëpo në sistem të doganës nuk janë bartë këto që 2 vite.

Naim Berisha, *Agribao*, ne merremi me shitjen e paisjeve bujqësore dhe ballafaqohemi me këto probleme jo vetëm me farëra por me shumë produkte të tjera. Problemi është te produktet që nuk ekzistojnë si emër në sistemin e integruar si fara e kungullit. Problem është sektori i tarifës së doganës dhe një person aty e ka të drejtën dhe kompetencën i cili është shef i sektorit të tarifave. Problem kemi edhe me Laktofriza që janë prodhime të BE-së, prodhuesi e dërgon si makineri të qumështit, kod që në tarifën e Kosovës është i liruar, ndërsa në kod e përcaktojnë në kuadër të frigoriferave dhe ne duhet me pagu doganë dhe TVSH. Pastaj shpërndarësit e plehut shtazor që nuk është rimorkio ndërsa ata e caktojnë në kodin e rimorkios. Për të zgjidhur këtë problem ai propozoi që në kudër të kodeve të shtohet edhe fara e kungullit dhe kodi 00.

Milazim Berisha, *Kryetar i Shoqatës së prodhuesve të qumështit*, tha se ky sektor ka shumë probleme. Kemi pasë takime me përfaqësuesit e doganës dhe na kanë premtu se do të rregullohen, por nuk është bërë asgjë. Kemi dërguar një shkresë në fund të vitit të kaluar edhe kryeministrit dhe ministrave në lidhje me problemet që na prekupojnë por nuk kemi marrë përgjegje. Në vendet e rajonit psh në Maqedoni çdo biznes në 10 vitet e para është e liruar nga të gjitha tatimet, investimet në bujqësi kanë përlkrahje të madhe.

Deputetët: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Salih Zyba, Andin Hoti dhe Salih Salihu, në kuadër të kësaj teme shtruan pyetje dhe kërkuan skjarime për këto probleme të paraqitura nga të ftuarit.

Kryetari, në fund, konstatoi: *se këta përfaqësues të shkruajnë një letër në lidhje me pretendimet që po ju bëhet e padrejtë me tarifat doganore dhe kërkesat e tjera, dhe pastaj do të ftohet drejtori i Doganës dhe Shefi i sektorit të tarifave, për të diskutuar në komision.*

7. Të ndryshme

Liburn Aliu, në fillim të mbledhjes e paraqiti nevojën për diskutim në lidhje me shpronësimin e një ndërtese, për të cilën Qeveria për nevojat e administratës ka marrë vendim dhe MMPH do të merret me shpronësimin. Ndërsa në fund në emër të tij deputeti **Salih Zyba**, kërkoi që të ftohet ministri i MMPH-së dhe zyrtarët përgjegjës të shpronësimit për të raportuara në komision.

Kryetari, në fund, konstatoi: *të ftohet Ministri i MMPH-së, dhe zyrtarët përgjegjës për shpronësim, për të raportuar në komision në lidhje me çështjen e shpronësimit të një ndërtese pas vendimit të Qeverisë.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj